

Njohja e diplomave

Diplomat dhe çertifikatat e huaja nuk janë gjithmonë të vlefshme në Zvicër. Në rrethana të caktuara, megjithatë, është e mundur të pranohen. Për disa profesione kjo është e domosdoshme.

Njohja

Personave me diplomë të huaj, sipas kushteve të ditura, diplomat mund t'iu njihen në Zvicër. Me njohje vërtetohet se një diplomë ose një certifikatë e huaj është e barasvlefshme me diplomën ose certifikatën zvicerane. Në profesionet e rregulluara (p.sh. profesionistët e kujdesit shëndetësor, mësuesit etj.) njohja është e nevojshme për të pasur mundësi për ta ushtruar profesionin. Për njohjen, sipas profesionit ose arsimimit, janë përgjegjëse organe të ndryshme. Njohja kushton. Jepin informacion:

- Pika kombëtare e kontaktit për njohjen e diplomave
- Zyra e specializuar Heks MosaiQ Zvicra Lindore
- Këshillimi profesional, studimor dhe i karrierës

Vërtetim mbi nivelin e arsimimit

Në profesionet e padefinuara me rregulla, nuk është e nevojshme njohja e diplomës ose kualifikimit për të punuar në Zvicër. Për këto profesione, mund të kërkohej një vërtetim i nivelit. Ky vërtetim tregon vlerën e diplomës së huaj në sistemin e arsimit zviceran (Schweizer Bildungssystem). Vërtetimi mund të ndihmojë në kërkimin e punës. Informacione mbi vërtetimin e nivelit mund të kërkohej në byronë e Kontaktit Kombëtar për Njohjen e Diplomave ose në shërbimet këshilluese për arsimimin dhe profesionin.

Arritja e kualifikimit profesional

Të rriturit me përvojë në profesion, por pa diplomë ose gradë të njohur, mund të marrin diplomë zvicerane të arsimit bazik (beruflichen Grundbildung) ose të arsimit të lartë profesional (höheren Berufsbildung). Procedura varet nga arsimi paraprak, përvoja në profesion dhe moshë. Në çdo rast, njohuritë e mira në gjermanisht janë kusht i rëndësishëm (nivel B1 / B2 sipas GER). Të interesuarit mund të informohen dhe të këshillohen në zyrën e informacionit për integrimin INFI.. Kush merr diplomë profesionale, përmirëson mundësinë e vet në tregun e punës dhe ka qasje në arsimim të mëtutjeshëm.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/puna/njohja-e-diplomave-2